# DËSHMI ARKIVI

**A-471994**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Eric Wendt i kujton Begajt problemet me grupet kriminale në takimin e parë në Tiranë |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394312.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 16:01:05 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 26 shtator 2026, 15:56:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 26 shtator 2026, 15:55:00 UTC → 26 shtator 2026, 15:57:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0b9214e026d11a4acc1d8c9d6afb5a3a5d05a78fb9b9dd97ec9226cc934c7105` |
| TEKSTI | `1385d0d8230e1d2628f2b6d2fe586d7f388052866203b71c9139c13405861f40` |
| PAMJA | `849722f35b8dc4965db8cae3a81d6e73768c945954db0f3debfcd2d31fbf3588` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e57e0df6b7fc2d89a93e80d7565b0fcc1e395b12e97e310aef95956201b8417c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0334a22cab892da6eda5613cc640e69aa8a23a21585bae5896651df887e79535` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e57e0df6b7fc2d89a93e80d7565b0fcc1e395b12e97e310aef95956201b8417c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Më të Lexuarat

ARTIKULL JOETIK?

# Eric Wendt i kujton Begajt problemet me grupet kriminale në takimin e parë në Tiranë

Shkruar nga: M Gjini | Publikuar më: 26.09.2026, 17:56

Share Share



Ambasadori i ri i Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, Eric Wendt, ka nisur zyrtarisht detyrën e tij në Tiranë, pasi i ka dorëzuar letrat kredenciale Presidentit Bajram Begaj.

Takimi mes tyre është bërë publik edhe nga Ambasada e SHBA-së në Tiranë, e cila përmes një reagimi në rrjetet sociale ka zbardhur temat e diskutuara gjatë takimit.

Sipas ambasadës, Wendt dhe Begaj riafirmuan partneritetin mes Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë, ndërsa diskutuan edhe për prioritetet e administratës së Presidentit Donald Trump.

Në fokus të bisedimeve ishin bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes, rritja ekonomike dhe lufta kundër grupeve kriminale transnacionale.

> *"Ambasadori Wendt dhe Presidenti Begaj riafirmuan partneritetin e fortë mes Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë dhe diskutuan për çuarjen përpara të përparësive të administratës së Presidentit Donald J. Trump, përfshirë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, rritjen ekonomike dhe luftën kundër grupeve kriminale transnacionale"*, thuhet në reagimin e Ambasadës së SHBA-së.

Wendt është ambasadori i ri amerikan në Shqipëri dhe pas paraqitjes së kredencialeve te Presidenti Begaj pritet të vijojë angazhimet e tij diplomatike në vend.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.